



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **16.03.2018**, me fillim në ora **10.15**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, Nënkryetarin Fatmir Iska, delegatët e pranishëm në këtë seancë të KPF-së, monitoruesit e KFORIT, OSBE-së, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Po e hapim mbledhjen e parë të KPF-së për vitin 2018, Kuorum për mbajtjen e mbledhje ka, Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

REND DITE

1. Shqyrtimi i bartjes së të hyrave vetanake nga viti 2017-2018,
2. Shqyrtimi i Raportit financiar të vitit 2017,
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm për shëndetësi,
4. Shqyrtimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit,
5. Shqyrtimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit 01 Nr. 585, rreth ndërtimit të palestrës sportive në Krushë të Madhe,
6. Shqyrtimi i Propozimit të Kryetarit 01 Nr. 124/2018 për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pronës së Paluajtshme komunale për “Ndërtimin e Palestrës Sportive”, në fshatin Krushë e Madhe.
7. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe,
8. Të ndryshme.

Desha të ju njoftoj paraprakisht se në emalin zyrtar na është kthyer një vendim si i kundërligjshëm nga MAPL-ja, Vendimin i anëtarëve të zgjedhur për KPF-në, ky vendim sipas MAPL-së është i kundërligjshëm për arsye se nuk është respektuar kuota gjinore, prandaj nga ne kërkohet që në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të bëjmë një zgjidhje. Po ashtu na është kthyer edhe një vendim si i kundërligjshëm nga MAPL-ja, vendimi për kompensimin e gjitha Komisioneve që formohen nga Kuvendi i Komunës, rekomandimi i MAPL-së është që të specifikohen se kush janë anëtar të komisioneve dhe sa komisione duhet që të paguhen.

Florije Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket këtyre vendimeve që janë kthyer nga ana e MAPL-së për arsye të disa lëshimeve që janë bërë me qëllim apo pa qëllim kjo fare nuk është me rëndësi. Sa i përket vendimit të KPF-së është mirë që të bisedohet edhe me partitë e tjera në Kuvend që të propozohet një grua, falënderoj për këtë MAPL-në që e ka kthyer këtë vendim, shyqyr që e kemi dikë që është duke na mbikëqyrur, e di që nuk kanë disa përvojë por besoj se me kalimin e kohës edhe ne do të bëhemi të afta si kolegët tanë. Qëllimi pse është kthyer vendimi për mëditje të Komisioneve është se është dashur të specifikohen pak më mirë, por mendoj se ata nuk mundën të na thonë neve që të çekim se sa komisione ne do ti formojmë, sepse ne brenda mandatit 4 vjeçar ose brenda një viti mundemi të formojmë komisione të ndryshme, po ndoshta është dashur të specifikohet se anëtarët e Kuvendit do të paguhen kurse shërbyesit civil sipas akteve që janë në fuqi nuk do të paguhen.

Kryesuesi – E qes në aprovim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i bartjes së të hyrave vetanake nga viti 2017-2018.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ata kuvendar që kanë qenë edhe në mandatin e kaluar kjo pikë e rendit të ditës ju është e njohur ku kemi të bëjmë me pjesën bartjes së të hyrave vetanake nga viti 2017 - 2018 që janë kryesisht të hyrat nga kodi 21. Totali i të hyrave vetanake në Komunën e Rahovecit të cilat barten në vitin 2018 janë në total prej 174,221.05 €, për investime kapitale 171,999.00 €, mallra dhe shërbime 29,35.00 € dhe subvencione 2,192.00 €. Në bazë të analizës së buxhetit dhe krahasime me borxhe ne jemi orientuar që ta bëjmë një shpërndarje shumë të drejtë në raport me këto relacione, kryesisht jemi fokusuar tek pjesa më e madhe e kontratave të cilat kanë borxhe edhe pse kjo është një shumë simbolike, pastaj prioritet tjetër i kemi dhënë edhe projekteve kapitale të cilat janë në linjë buxhetore të vitit 2018, mirëpo si mjete që janë shumë pak të shpërndara, po ashtu ne i kemi futur edhe 3 projekte të reja në bazë të kërkesave dhe nevojave emergjente të cilat kanë dalë nga qytetarët. Projektet e reja janë ndërtimi i kanalizimit në Komunën e Rahovecit në disa rrugë sekondare, kjo ka ardhur sipas kërkesës së drejtorisë së shërbimeve publike të cilat vazhdimisht kanë kërkesa nga qytetarët e ndryshëm të cilat në një formë apo tjetrën nuk kanë mundur të kycen, si projekt i ri tjetër është rregullimi dhe rrethimi i fushës së sportit në fshatin Ratkocë edhe kjo ka dalë si kërkesë nga Drejtoria e Kulturës, me arsyetimin se në fshatin Ratkocë ka qenë një fushë shumë e mirë, por edhe unë jam dëshmitar dhe e kam parë që kjo fushë gati është tjetërsuar sepse aty parkohen edhe automjete me pesha të rënda dhe pastaj aty ka lëvizje të mëdha prandaj është paraqit si nevojë emergjente me e bërë një rrethim dhe ne kemi ndarë një shumë prej 4,000.00 €. Si projekt tjetër i ri është riparimi i shtëpisë së kulturës gjithashtu edhe ky projekt ka dalë në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, personalisht nuk e kam parë objektin fizikisht, por sipas disave thonë se çatia e kësaj shtëpie është e shkatërruar dhe ka rrjedhje të vazhdueshme të ujit dhe si pasojë e kësaj janë prishur edhe muret.

Florije Boshnjaku – I nderuari drejtor mos është bërë ndonjë gabim teknik tek mallrat dhe shërbimet i kemi vetëm 29.00 €. Pastaj tek të hyrat dhe bartjet tek neni 1 ku ceket: Kuvendi i Komunës miraton vendimin ku i lejohej bartja e mjeteve vetanake të shpenzuara nga viti 2016 – 2017, mos duhet të ceket vetëm viti 2017 apo duhet të ceket viti 2016 dhe 2017.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetja ime për Drejtorin e financave është se mjetet vetanake të shpenzuara të vitit 2016 a nuk janë bartur të gjitha vitin e kaluar, po ashtu kisha pas dëshirë të di se sa mjete nuk janë shfrytëzuar të viti 2016 dhe sa janë nga viti 2017 dhe pse nuk janë bartur ato në vitet përkatëse. Përndryshe jam pro asaj që të barten mjetet në mënyrë që mos të i humbim këto mjete.

Afrim Limani – Të nderuar mjetet të cilat janë bartur nga viti 2016 në 2017 por që nuk janë shfrytëzuar në vitin 2017 gjithsej vlera e tyre është 4,000.00 € dhe këto e kanë numrin e kodit 22, kjo nuk është një shumë e madhe por është një shumë simbolike që për arsye të ndryshme nuk janë shfrytëzuar, për mënyrë një shembull një projekt kapital ka qenë me pjesëmarrje 80% nga grandit kurse 20 nga të hyrat vetanake dhe nga kodi 22 një shumë më e vogël simbolike, por për arsye të ndryshme ky projekt nuk ka mundur të realizohet ose është realizuar por pagesa nuk ka mundur të bëhet, pastaj këto mjete barten në vitin pasues që e kemi. Zakonisht këto mjete nga kodi 22 janë në masë shumë të vogël simbolike dhe në shumë projekte diku 200 € diku 500 €, pastaj ne i mbledhim si total dhe i bartim në vitin pasues, në këtë rast ne i kemi 4,000.00 €. Znj. Florije pyetjen që e parashtroni sa i përket shumës 29.00 € është e saktë nuk është bërë ndonjë gabim, për pyetjen e dytë besoj se mori edhe ajo përgjigje.

Dervish Qadraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, uroj që kjo mbledhje e parë dhe gjitha mbledhjet gjatë mandatit të jenë të suksesshme në mënyrë që gjatë gjithë mandatit të punojmë në interes të qytetarëve. Kjo bartje e mjeteve sigurisht që është e domosdoshme për tu bartur në këtë vit, por më befason një fakt që më parë nuk ka qenë bartja e mjeteve nga viti 2016 në vitin 2017 dhe 2018, nuk e di pse ka mundur të ndodhë kjo, uroj që tash e masë të mos ndodhin kështu praktika dhe të kemi kujdes pak më tepër e sidomos drejtoria i financave që mos të lejojnë që kjo praktikë të ndodhë herë pas here.

Kryesuesi – E qes në votim pikën Shqyrtimi i bartjes së të hyrave vetanake nga viti 2017-2018: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Raportit financiar të vitit 2017.

Dervish Çadraku - Të nderuar nuk e di a jeni të pajtimit edhe ju por kisha propozuar që mbledhjet e KPF-së të i mbajmë në sallën e bordit të drejtorëve tek zyra e Kryetarit sepse ma merr mendja se është më produktive se sa kështu që jemi duke i mbajtur sepse ne duhet që të lëvizim poshtë lartë.

Kryesuesi – I nderuari z. Dervish Çadraku jemi të obliguar që ta mbajmë në këtë sallë për arsye se këtu incizohen bisedat, lartë nuk mundemi, sido që të jetë ju faleminderit për propozimin.

Afrim Limani - Raporti financiar për vitin 2017 edhe pse të dhënat e këtij raporti kanë të bëjnë me qeverisjen e kaluar por kemi pasur fatin që ne si drejtori e financave ta përpunojmë këtë raport. Do ju them me një sinjoretet më të madh se ky raport është punuar ashtu siç janë zhvilluar edhe ngjarjet, është në pajtueshmëri të plotë me Ministrinë e Financave kryesisht me departamentin e thesarit. Nuk do të ndalem shumë në këtë raport por në vija të trasha do ju japë sqarime po ashtu do ju lë hapësirë që ju të bëni pyetje kurse përgjigjet e mija do të jenë aq sa mundem dhe aq sa di që i përket këtij raporti. Të hyrat e rregullta për vitin 2017 kanë qenë 820,866.47 € nëse e krahasojmë me vitin e kaluar që kanë qenë diku 877,833.87 €, kemi një rrënjë prej 56,967.00 €, kurse të hyrat në total së bashku me gjokat e gjykatave dhe gjokat e trafikut kanë një rritje më të madhe dhe diferenca është diku 70,563.00 €. Buxheti është realizuar në masën e kënaqshëm 97 % dhe kjo është diçka shumë mirë dhe shumë pozitive sepse asnjë cent nuk ka shkuar në suficit, kurse ky 3% i mbetur është pikërisht nga të hyrat vetanake që janë bartur në vitin 2018. Në faqe nr. 19 tek kolona e shpenzimit të buxhetit sipas mallrave dhe shërbimeve e kam futur aty edhe një shtyllë vertikale ku cekën borxhet e bartura nga viti 2017 në 2018, shtrohet pyetje pse e kam bërë këtë, e kam bërë me arsyetimin se kur e paraqes raportin tim mos të thoni pastaj se si ky raport për 3 muaj është ngarkuar aq shumë. Gjithashtu krejt në fund e kam një rekapitullim të borxheve financiare dhe atyre kontraktuale, por besoj se më gjerësisht këtë pikë do ta diskutojmë në mbledhjen e kuvendit, për Kuvend e kam me paraqit ma shumë material të përshkruar në mënyrë shumë specifike për çdo operator aty do të paraqitet çdo borxh dhe çdo kontratë. E kam para vete një pasqyrë ku borxhi i përgjithshëm financiar është 2,243,676.00 € për të gjitha kategoritë, kurse tabelari mëposhtëm cekën obligimet kontraktuale duke filluar nga viti 2012 – 2017, ku në çdo shtyllë janë të specifikuar të gjitha si kontrata, aneks kontrata, pagesa, borxhi i mbetur dhe në fund do të paraqiten obligimet financiare.

Florië Boshnjaku – Më vije shumë mirë Drejtor që nuk ja keni nisur me vajtime sikurse qeverisja e kaluar edhe pse më vije shumë keq që po e them këtë, në çdo mbledhje kanë vajtuar se i kemi lanë borxh, kur i merr të drejtat duhet që ti marrësh edhe obligimet. Ajo që më intereson mua më së shumti është se tek obligimet financiare janë 2,243,676.00 € kurse obligimet kontraktuale a janë 6,703,000.00 €, i nderuar Drejtor obligimet financiare a janë të përfshira edhe tek obligimet kontraktuale nëse po atëherë i gjithë borxhi është 6,703,000.00 €.

Dervish Qadraku – Mendoj se ky raport financiar të cilin e kemi ne para vetes nuk ka shumë mundësi që të përgjigjet Drejtori i tanishëm, por siç e thashë edhe më parë në këtë raport ka disa gjëra që nuk kisha pas dëshirë që të ndodhin në këtë mandat, ka vërejtje me të cilat ka njëherë me të vërtet po befasohem ti kalojnë ose ti anashkalojnë nuk e di se si ti kualifikoj këto, do të shkojmë me radhë nëpër çdo fletë që ta diskutojmë këtë raport sepse është i ngarkuar dhe nuk mundem me dy tre fjali ta përshkruaj. Tek të hyrat në faqe nr. 3 planifikimi është bërë për të gjithë muajt e vitit i njëjtë 103,977.00 € ky është jo profesionalizëm total sikurse të mos kenë pasur fare përvojë në këtë drejtim të paktën është dashur të bëhet një diferencë e vogël nga muaji në muaj është dashur të tregohet një lloj serioziteti dhe profesionalizmi, prandaj mendoj se ky ka qenë vetëm një planifikim formal. Pastaj në faqen 6 kemi taksën për legalizim të objekteve, në vitin 2016 kemi taksën 17,453.00 € kurse në vitin 2017 nuk kemi fare këtë taksë, nuk mundem ta kuptoj këtë, kishte me qenë mirë me aq mundësi sa ka Drejtori të na jep një përgjigje. Participimin në shëndetësi e kemi në vitin 2016 me shumën prej 36,285.00 € kurse në vitin 2017 kemi vetëm 16,877.00€. Po ju tregoj një rast që më ka ndodhur mua para disa dite më datën 07.03.2018 isha në QKMF në Rahovec dhe kërkova që të bëj disa analiza, atë ditë nuk ka pasur as regjencia as epruveta, nuk ka pasur asnjë element që të kryhen analizat, kam shkuar prapë në javën tjetër me datën 12.03.2018 po ashtu edhe në këtë ditë ka vazhduar që të mos ketë mundësi për të kryer analizat. Në vitin 2017 ka pasur subvencione 16,700,00 € kurse për vitin 2017 kemi shpenzime kapitale në shëndetësi 296,000.00 € kurse në mallra dhe shërbime kemi 169, 998.00 €. Paramendo tani nuk ke mundësi ta kryesh një shërbim, lind pyetja për çka janë ata aty nëse nuk ke kontrollimin e shtypjes së sheqerit

në gjak kurse këtu ka disa të hyra dhe disa shpenzime dhe me të vërtetë befasonet njeriu pse nuk mundemi të i marrim këto shërbime. E di se është qeverisja e re por në këtë duhet ta kemi si vërejtje që ju si qeveri e re dhe ne si përfaqësues të popullit të bëjmë asi punë me të cilët qytetarët duhet të jenë të kënaqur, nëse vazhdohet me këso praktika të njëjta atëherë ne jemi kot këtu. Kemi pastaj gjërat nga inspektorati gjithsej janë 10.00 €, a ka punuar ky inspektorat diçka është mirë që të na përgjigjeni për këtë. Pastaj në faqe nr.10 është mirë që ti futni përqindjet në mënyrë që ne mos ti nxjerrim me kalkulator tanë, ka disa pyetje këtu ku z. Afrimi nuk është shumë kompetentë ndoshta për tu përgjigjur. Pastaj tek shpenzimet e telefonave kemi rritje të shpenzimeve nga viti 2016 – 2017 në dy ose tre fish ma shumë, besoj se këto vërejtje duhet që të evidentohen, në vitin 2016 kemi 2,785.00 € kurse në vitin 2017 kemi 9,770.00 €. Pastaj kemi mirëmbajtjen e shkollave kodi 4023 faqe nr.20 ku shuma është 44,000.00 € ndërsa kur shkon dhe i shikon shkollat janë në një gjendje të mjerueshme, pe mare një shembull në fshatin Gexhe ka 10 vite që kjo shkollë pikë në të gjitha anët dhe askush nuk është marrë me këtë punë, nuk e di në këto mirëmbajtje a përfshihet edhe qatja apo vetëm mirëmbajtja poshtë mureve, pra në disa shkolla nuk jemi askund sa i përket mirëmbajtjes, kjo ke vetëm një lloje vërejtje për qeverisjen e kaluar sepse ju nuk jeni kompetent dhe fajtor për këtë. Kemi dreka zyrtare në vitin 2016 në kodin 410 me shumën prej 4,310.00 € kurse në vitin 2017 kemi një rritje në 9,699.00 € pra është një dallim shumë i madh, disa njerëz nuk kanë me çka të ushqehen kurse ne i harxhojmë nga afro 10,000.00 € për dreka darka edhe pse ata munden që të arsyetohen me letra.

Rasim Fazliu – Fillimisht e falënderoj Drejtorin që na ka ofruar këtë raport financiar, në këtë mbledhje të KPF-së nuk do të zgjerohem shumë sepse besoj se më tepër do të diskutojmë në mbledhje të Kuvendit. Ajo që desha të cekim është se është bërë shumë mirë që është bërë realizimi i mjeteve për vitin 2017 e tha edhe Drejtori këtë, do të ndalem pak tek faqja e fundit e këtij raporti ku i kisha propozuar Drejtorit të Financave që për mbledhjen e Kuvendit të na sjellë në mënyrë pak ma të detajuar dhe të na tregoj emrat e kontratave, pastaj ndër vite kjo kontratë sa është realizuar, p.sh sa janë paguar në vitin 2012, 2013, 2014 e kështu me radhë dhe ne me ditë se sa është borxhi i fundit që ka mbetur pa paguar. Sigurisht pastaj kolegja znj. Florije Boshnjaku do ta ketë të qartë se sa janë borxhet e faturuara dhe sa janë borxhet e kontraktuara, nëse ne kemi kontrata të lidhura për 3 - 4 vite normalisht që ato nuk munden të futen si borxhe sepse ato duhet të kryhen në vitet e ardhshme, mirë e tha edhe z. Dervish Qadraku që duhet që të punojmë pa tendencë dhe mirë në interes të qytetarëve. Tek obligimet financiare te faturat në pritje për pagesë nuk e di ose unë mundem me qenë gabim ose nuk janë të mbledhura këto shifra të gjitha sepse diku ka dalë shuma 2,044,360.29 € nëse i mbledhim të gjitha këto shifra do të dele një shumë tjetër. Sa i përket borxheve unë e konsideroj borxh i pastër faturat që janë në pritje.

Florije Boshnjaku – Sa i përket obligimeve financiare dhe obligimeve kontraktuale më vije mirë që jeni duke e bërë tani dallimin, këto dallime i kam bërë unë atëherë por ju thoshit neve nuk na intereson borxhe janë, ka kontrata që janë 3 vjeçare, në çdo mbledhje së pari kemi dalë nga takti sepse gjithmonë disa drejtor e përmendnin se i kemi lënë borxhe, propozimi imë i Kryetarit dhe Drejtorëve është që mos të thirremi në të kaluarën por ne të shikojmë përpara dhe të punojmë sepse çdo njëri kur i merë të drejtat duhet që ti merë edhe obligimet dhe shumë qartë e kam se çka është obligimi financiar dhe çka është obligimi kontraktual, e kam thënë dhe prapë po e them çdo qeveri që vije në pushtet i ka të drejtat dhe obligimet.

Afrim Limani – E nderuar z. Florije Boshnjaku shuma prej 2,044,360.29 është në kuadër të obligimeve kontraktuale pra në kuadër të 6,703,000.00. z. Dervish Qadraku i beri një mori pyetjesh, për të gjitha pyetjet që jam në ngjarje besoni se në mënyrën më të sigurtë do ju përgjigjem. Tek të hyrat vetanake e thatë që është bërë planifikimi i gabuar, planifikimi i të hyrave vetanake për Komunën e Rahovecit ka qenë 1,247,732.00 € pastaj kjo është përpjesëtuar me 12 muaj dhe mesatarja për çdo muaj ka dalë 103,997.00 €. Në faqen tjetër mund të shihni se si sipas muajve në raport me planifikimin janë realizuar, përpos muajit mars që ka pasur një rekord të hyrave muajt e tjerë kanë qenë nën planifikim. Tek taksa për legalizimin e objekteve në vitin 2016 kanë qenë 17,453.00 € kurse në vitin 2017 nuk ka pasur fare, pse ka ndodhur kjo edhe unë nuk e di por jam shumë i besimit se kjo taksë është transferua në një kod tjetër por për ma shumë unë do interesohem. E përmendët edhe mirëmbajtjen e shkollave, e arsyetoj atë shpenzim që është bërë sepse ai projekt realizohet në bazë të kërkesave të shkollave, pastaj formohet komisioni dhe e vërteton a duhet që të rregullohet në këtë shkollë ai problem, por ky kod është shpenzim i cili i përfshin të gjitha shkollat e Komunës së Rahovecit. I nderuari z. Rasim Fazliu parashtroi disa pyetje, i nderuar bartja e borxheve financiare do të jetë një pikë e

veçantë të cilën do ta trajtojmë në Kuvend dhe në atë pikë do të jenë të përfshirë të gjitha ngjarjet që janë zhvilluar nga viti 2012 – 2017, aty janë operatorët ndër vite, kontrata, aneks kontrata, pagesat, sa kanë mbetur borxh, pastaj sa i mbulon borxhet viti 2018 dhe sa mbeten borxh për vitin 2019, pra ky do të jetë një raport i detajuar dhe i harmonizuar gjithmonë me Drejtorin e Financave.

Rexhep Oruqi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, nuk do të lëshohet shumë në analizën e raportit financiar të viti 2017 sepse ne si Komitet edhe sipas rregullores dhe të gjitha akteve normative të cilat janë në fuqi, ne si KPF i japim vizën Kuvendit dhe në parim ne i japim mundësin se kjo pikë a mundet të shkojë për Kuvend apo jo, nëse lëshohemi ne në detaje dhe e debatojmë dy orë raportin i cili do të dele në kuvend për tu debatuar është pak absurde. Duhet që të diskutohet në pika të shkurta, të jepet ndonjë sugjerim dhe në parim ta votojmë dhe të ecim përpara e mos të zgjasim KPF-në ma shumë se Kuvendin. Ka punuar 4 vite ekzekutivi i kaluar ndoshta ka lënë edhe dobësi, janë tejkaluar disa gjëra, nuk janë përmbushur disa gjëra financiare por në parim aty jemi sepse obligimet njëri tjetrit do ti lihen edhe në të ardhmen. Pra propozimi imë është jo vetëm për këtë pikë por edhe për pikat e radhës vetëm në parim të diskutohet.

Fehmi Cena – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, desha të ndërldhem në diskutimin sa i përket shëndetësisë, e ceku shumë mirë edhe kuvendari z. Dervish Qadraku që është mirë të sqarohen pak ma mirë gjërat që të jenë më të kuptueshme sepse edhe unë nuk i kam shumë të qartë këto tabelat. Në faqe nr.6 të hyrat në shëndetësi për vitin 2016 ceket se janë 36,235.20 € kurse për vitin 2017 janë 16,877.30 €, ndërsa pas dy faqe aty ku ceken të hyrat sipas muajve ceket se në shëndetësi planifikimi është 60,000.00 € kurse të realizuara 36,412.70 €. Pyetja ime është: Cila është vlera e të hyrave për vitin 2017 në shëndetësi, mendimi imë është se janë realizuar 36,412.70 € nuk e besoj se kjo diferencë qëndron siç e keni cekur më lartë ndoshta është bërë ndonjë gabim teknik. Kisha kërkuar që në mbledhjen e ardhshme këto gjëra të na sqaroni që ti kemi më të qarta dhe të dimë saktë se sa janë të hyrat për vitin 2017.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutim, kalojmë në pikën e radhës.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm për shëndetësi.

Binak Kryeziu, auditor i brendshëm – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, njësia e auditimit të brendshëm ka kryer një raport final në muajin qershor të vitit 2017, raporti final është kryer në bazë të planit vjetor të vitit 2017 ku është paraparë të bëhet auditimi i 3 muajve të parë të vitit 2017 ku janë paraparë 8 objektiva ku si objektiv kryesor kanë qenë të hyrat vetanake, gjatë auditimit kemi hasu në të gjetura ku kemi rekomanduar po ashtu 6 rekomandime. Kryesisht me këto rekomandime duhet që të merret menaxhimenti i QKMF-së sepse kryesisht auditimi është bërë në QKMF, shumica nga rekomandimet janë implementuar. Besoj se e keni lexuar raportin që ju kemi dërguar unë nuk kam çka të shtoj më tepër.

Flori Boshnjaku – Falënderoj auditorin që na ka sjellë këtë raport të cilin e kam lexuar me vëmendje edhe pse ky raport nuk ka kurrfarë rëndësie, tani me siguri është bërë edhe raporti i auditorit të jashtëm po ashtu edhe ne kurrfarë masa nuk mundemi me ndërmarr për raportin e 3 muajve për vitin 2017. Ky raport mendoj që së pari është dashur të dorëzohet ish Kryetarit të Komunës z. Idriz Vehapi e pastaj ai të shikoj se ku e ka gjendjen dhe ka duhet që të shkojmë. Qysh në fillim në fletën e parë të këtij raporti ceket auditimi i brendshëm në Drejtorin për Shëndetësi, a është dashtë të jetë për Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale apo vetëm QKMF, kjo është pyetje ime kryesore, nëse është bërë auditimi vetëm tek të hyrat e QKMF-së, por ky raport nuk është vetëm për të hyrat vetanake që i realizon QKMF-ja, ky raport është edhe për barnat esenciale dhe materiali shpenzues, ky raport nuk e di ku e ka bazën sepse nuk është i mbështetur në bazë të statutit të QKMF-së, në statutin e QKMF-së nuk e kemi departamentin e maternitetit. Nëse lëshohemi vetëm për të hyrat vetanake të QKMF-së e jo të Drejtorisë, por unë në këtë raport shoh edhe subvencionet dhe këto mjete i ka ndarë Drejtoria për Shëndetësi kryesisht Kryetari i Komunës këtu asgjë nuk ka të bëjë me kujdesin primar shëndetësor, këtu ka shumë çështje të tjera që janë të paqarta për vetë auditorët e mos të diskutojmë për ne Kuvendarët e Kuvendit.

Fehmi Cena - Ky është një raport i auditimit të brendshëm që ka të bëjë me 3 muajin e parë të viti 2017, sa e kam kuptuar unë në këtë auditim janë përfshirë QKMF-ja dhe Drejtoria për Shëndetësi. Tek struktura e organizimit të QKMF-së në statut është bërë një lëshim sepse departamenti i maternitetit nuk ekziston dhe kjo duhet që të hiqet, ka vërejtje tek disa pika që është bërë auditimi, duke i shqyrtuar së bashku me QKMF-në dhe Drejtorin e Shëndetësisë ku kam marrë pjesë edhe unë si udhëheqës i departamentit të njësisë familjare këto rekomandime, mendimi imë për këto rekomandime sa i përket QKMF-së nuk jam pajtuar plotësisht, por

disa kanë bazë dhe mendoj po ashtu se disa nga ta janë plotësuar, besoj se është e nevojshme të bëhet edhe auditimi tjetër në mënyrë që ne të shohim krahasimin e tyre. Do të ishte kompetentë Drejtori i Shëndetësisë që të jetë prezent sot këtu dhe ai të na sqaroi saktësisht gjendjen e këtyre rekomandimeve dhe të në tregoj se a qëndron kjo apo jo.

Rasim Fazliu – Falënderoj z. Binak Kryeziun që na ka sjellë këtë raport të auditimit për 3 mujorin e parë të viti 2017. Pyetje ime për auditorin është pse nuk e ka bërë auditimin për komplet vitin duke u bazuar në atë që kanë pasur edhe kohë, për ma shumë do të diskutojmë në mbledhje të Kuvendit.

Dervish Qadraku – Mendoj se kanë qenë dy arsye pse nuk jemi marrë shumë me këtë raport të auditimit të brendshëm sado që kjo është punë profesionale e z. Binak Kryeziut, pyetja ime për auditorin është pse nuk është dorëzuar ky raport vitin e kaluar ish Kryetarit dhe e dyta që nuk është shumë e nevojshme të flitet është me të vërtetë mirë e tha kolegu z. Rexhep Oruçi se nuk duhet të zgjasim ma tepër, sepse të njëjtat fjalë që i ceku e nderuara znj. Florije Boshnjaku dhe doktori në fakt kisha ndërmend që ti them edhe unë, por mendoj se kishte më qen më mirë që të kemi raportin e vitit sepse raporti 3 mujor është një lloj orientimi në mënyrë që mos me i lënë me dalë jashtë kontrollit ose jashtë suazave normale një qeverisje, prandaj mendoj se ky raport 3 mujor ma shumë i ka shërbyer qeverisjes së kaluar si orientim se sa neve sot. Po ashtu edhe unë nuk kam çka të shtoj më tepër, më shumë do të diskutojmë në mbledhje të kuvendit.

Binak Kryeziu – Ky raport është pjesë e planit vjetor të viti 2017, raporti nr.3 që u parapa në planin vjetor dhe data e auditimit ka filluar me 01.05.2017 dhe në planin vjetor janë paraparë që të auditohen 3 muajt e parë, prandaj ne nuk kemi mundur 6 muaj ose 1 vit me bërë auditimin. Ndërsa në raportin vjetor parashihen 7 auditime dhe çdo auditim e ka afatin e vet kur dihet që të auditohet, planin vjetor e ka miratuar ish Kryetari i Komunës, tani Kryetari aktual mundet që të aprovoj planin vjetor për vitin 2018. Auditimi është bërë kryesisht në QKMF dhe Drejtorin e Shëndetësisë, ku janë paraparë 8 objektiva, objektiva kryesore ka qenë të hyrat vetanake, barazimi dhe harmonizimi i tyre, kurse objektivat e tjera kanë qenë sa i përket subvencioneve, barnave esenciale etj.

Florije Boshnjaku – Pe ceki edhe një herë është shumë pak me rëndësi ky raport i auditimit, por raporti tjetër i cili do të përpilohet duhet të ceket Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, nëse auditohet vetëm QKMF duhet të shënohet Kujdesi Primar Shëndetësor – QKMF-ja, nëse auditohet Drejtoria për Shëndetësi dhe subvencionet duhet të ceket që auditimi është kryer në Drejtori për Shëndetësi – QKMF, duhet që të mirëtohet statuti i QKMF-së, nuk jam duke u marrë me të kaluarën jam duke u marrë me të ardhmen dhe në bazë të kësaj duhet që të shkoj renditja sepse ky është një dokument zyrtar.

Kryesuesi – Nëse nuk ka kush të shtoj diçka më shumë kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit.

Samir Mustafa – Përhëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, duke u bazuar në nenin 11, nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës nenin 9, nenin 40, nenin 74 dhe nenin 92 Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës miratimin e vendimit me të cilën i lejohet Kryetarit të Komunës që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit të lidhë marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare të cilat veprojnë në Komunën e Rahovecit. Pas konsultimit me Bashkësinë Islame pakoja e shërbimeve primare do të definohet me një marrëveshje të re e cila nuk mundet ta ketë koston më të lartë se 180.00 €, ndërsa shërbimet e tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes qytetarët janë të obliguar që ti sigurojnë personalisht. Pagesa ndaj Bashkësisë Islame do të jetë retroaktive pra nga 1 janari i vitit 2018, të nderuar kuvendarë ju ftoj që ta miratoni propozimin e Kryetarit të Komunës.

Florije Boshnjaku – E di që ky është një propozim vendim me vend edhe atëherë ka qenë edhe tani është, vendimi i kaluar ka qenë deri me 31 dhjetor 2017 kurse tani duhet që të miratohet një vendim i ri. Pyetja ime për ju është: A ka borxh ende Komuna për ti paguar Bashkësisë Islame për shpenzime të varrimit apo i keni kryer të gjitha obligimet, sa e di në vitin 2017 shuma për shpenzime të varrimit ka qenë 200.00 €, a jeni marrëveshje që të zbritet kjo shumë për 20 € apo nuk po mundet ti përballoj shpenzimet Komuna dhe për këtë arsye e keni zbritur për 20 €.

Fehmi Cena - Gjithçka është sqaruar tani se nuk e kam pas të qartë sepse nuk e kam ditur që çdo vit duhet të mirëtohet vendimi i ri, tash e kuptova dhe çdo gjë është në rregull.

Nënkryetari – Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, ky vendim ka qenë që nga viti 2015 -2017 ku janë paguar nga kodi i subvencioneve kurse tani ka kaluar në kodin e mallrave dhe shërbimeve, pikërisht pse janë

ndarë nga kodi i subvencioneve nga zyra e Kryetarit studentët e Komunës së Rahovecit për 3 vite nuk kanë përfituar asnjë bursë. Ne kemi pas një takim me Kryetarin e Bashkësisë Islame të Rahovecit ku kemi diskutuar mundësin e vazhdimit të vendimit për shërbime të varrimit me një kosto për vitin 2018 që të jetë 180.00 € duke i llogaritur shpenzime bukur të mëdha që bëhen nga këto shërbime të varrimit në kodin e mallrave dhe shërbimeve, përfaqësuesit e Bashkësisë Islame janë pajtuar që ne me e vazhdu këtë vendim për vitin 2018 me vlerën prej 180.00 € për një rast vdekje, e keni edhe specifikacionin mbrapa që i parasheh të gjitha shërbimet që duhet të kryhen. Meqenëse vendimi merret për një vit është rregull që edhe kësaj radhe me e vazhdu me e votu në Kuvend për vitin 2018, ne si komunë jemi pajtuar pasi jemi në fund të muajit mars pagesa të bëhet retroaktive ndaj Bashkësisë Islame për çdo rast të vdekjes që ka ndodhur në Komunën tonë, ideja e Komunës është me e vazhdu përkrahjen në mënyrë që të ecim më tutje deri sa të miratohet nga Kuvendi i Kosovës ligji për bashkësitë fetare, nëse parashihet diçka aty sa i përket shërbimeve të varrimit atëherë Komuna do ta ketë më lehtë sa i përket buxhetit, nëse jo do të shikojmë mundësinë e miratimit të një rregullore komunale që do ti parasheh këto shërbime të varrimit.

Kryesuesi – E qes në votim Shqyrtimin e propozim vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 4 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë:

5. Shqyrtimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit 01 Nr. 585, rreth ndërtimit të palestrës sportive në Krushë të Madhe.

Ervin Hoxha – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, Duke u bazuar në nenin 11, nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03 L/040 dhe Gazetës Zyrtare të republikës së Kosovës 28/2008 dhe nenit 9 pika 2, nenit 40, nenit 74 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të dt. 29.07.2015, kërkesës me Nr. Protokollit 189 të dt. 05.03.2018, Kryetari i Komunës i propozon KPF-së dhe Kuvendit të Komunës që të merë vendim për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 585 të dt. 28.02.2017. Shfuqizimi i këtij vendimi kërkohet për arsye se në Krushë të Madhe ku është planifikuar ndërtimi i kësaj palestre sportive në parcelën P-715130005-00 524-0 e cila është pronë shoqërore e Republikës së Kosovës në vendin e quajtur vinogradi, problemi qëndron se aty nuk mundet të ndërtohet palestra sportive për shkak se në atë parcelë gjendet lapidari i dy dëshmorëve të Kombit “Dalip Behra” dhe “Bekim Gashi” nga Krusha e Madhe, prandaj kjo patundshmëri nuk mundet të shfrytëzohet për ndërtim të kësaj palestre sportive.

Nënkryetari – Vetëm një sqarim sa i përket dy pikave të rendit të ditës, Shqyrtimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit 01 Nr. 585, rreth ndërtimit të palestrës sportive në Krushë të Madhe dhe po ashtu kemi pikën e radhës Shqyrtimi i Propozimit të Kryetarit 01 Nr. 124/2018 për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pronës së Paluajtshme komunale për “Ndërtimin e Palestrës Sportive”, në fshatin Krushë e Madhe. Ne kemi pasur edhe një kërkesë nga kryesia e fshatit Krushë e Madhe që ka qenë pengës ky vendim për ndërtimin e palestrës i cili është marrë në vitin 2017, por si duke në atë kohë nuk e kanë vërejtur se në këtë parcelë është edhe lapidari i dy dëshmorëve të kombit, nëse ndërtohet në këtë vend salla sportive atëherë do të bllokohet komplet ajo hapësirë, prandaj ne nuk jemi të interesuar që të ndërtojmë në këtë parcelë këtë palestër sepse dëshmorët kanë dhënë gjak për këtë vend e neve na mbetet vetëm që ti respektojmë. Ne tani kemi ndarë një vend tjetër në pajtim edhe me Kryesinë e fshatit Krushë e Madhe, këto dy pika janë të ndërlidhura njëra me tjetrën njëra shfuqizohet kurse propozimi tjetër është mirë që të aprovohet dhe të shpallet interesi i përgjithshëm, po ashtu është mirë që të shpallet interesi i përgjithshëm varrezat ose lapidar i dëshmorëve në mënyrë që mos të krijohen pengesa tjera më tutje.

Rexhep Oruqi – Pasi këto dy pika lidhën njëra me tjetrën kishte me qenë mirë që të debatohet për të dyja pikat në të njëjtën kohë e pastaj të votojmë një herë për shfuqizim të njëres pikë dhe fuqizim të pikës tjetër.

Dervish Qadraku – Ajo që më intereson mua është ajo sipërfaqe që është propozuar në 2017, lapidarët a janë brenda kësaj parcele apo janë afër kësaj parcele.

Nënkryetari – I nderuar z. Dervish Qadraku këta dy lapidar të dëshmorëve janë brenda kësaj parcele.

Flori Boshnjaku – Sa i përket kësaj pike unë edhe në vitin e kaluar kur ka ardhur si pikë e rendit të ditës në Kuvend kam kërkuar që të na sillen pëlqimi i fshatit, pra së pari të konsultohen me kryesinë dhe këshillin e fshatit por nuk na është sjellë, kurse tani e kemi pëlqimin e kryesisë së fshatit. Propozimi imë është që tek pjesa hyrëse e vendimit të jetë kërkesa e këshillit të fshatit Krushë e Madhe numri i protokollit është i cekur.

Rasim Fazliu – Mendoj se nënkryetari i Komunës na dha sqarime të mjaftueshme, por është mirë që herrave tjera përmes projektorit të na prezantoni skicën në mënyrë që të dimë edhe ne se ku gjendet, ndoshta nuk ishim lodhë duke bërë pyetje. Mendoj se nuk kemi çka të diskutojmë më shumë sot në KPF le ta votojmë dhe në Kuvend do ta diskutojmë më shumë, por ajo që më ka shqetësuar edhe atëherë por edhe tani është se a keni menduar për infrastrukturë përcjellëse si uji, rryma etj.

Kryesuesi – E qesim në votim një herë Shqyrtimin e propozimit të vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit 01 Nr. 585, rreth ndërtimit të palestrës sportive në Krushë të Madhe: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 5 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

6. Shqyrtimi i Propozimit të Kryetarit 01 Nr. 124/2018 për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pronës së Paluajtshme komunale për “Ndërtimin e Palestrës Sportive”, në fshatin Krushë e Madhe.

Edhe për këtë pikë diskutoam së bashku me pikën e pestë të rendit të ditës tani na mbetet vetëm që ta qesim në votim Shqyrtimi i Propozimit të Kryetarit 01 Nr. 124/2018 për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pronës së Paluajtshme komunale për “Ndërtimin e Palestrës Sportive”, në fshatin Krushë e Madhe: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 6 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

7. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.

Ne sot duhet që të marrim vendim për fillimin e procedurave për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, do ju lexoj disa pika të udhëzimit administrativ i cili e precizon në detale se si bëhet themelimi i këtij këshilli. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit organizohet nga Kuvendi i Komunës sipas procedurave në vijim: Kuvendi i Komunës nxjerrë vendime për themelimin e Këshillit, pas nxjerrjes së vendimit nga paragrafi 1.1 i këtij neni, shpallet ftesa publike sipas së cilës paraqesin kandidaturën e tyre për tu bërë anëtarë të këshillit në afat prej 15 ditësh duke i ftuar kandidatët e interesuar të paraqesin aplikacionet e tyre për anëtar të këshillit. Pastaj Komuna e njofton Kishën Ortodokse serbe, Kryesin e fshatit dhe banorët për ftesën publike. Kuvendi Komunalë zgjedh komisionin ad – hoc i cili përbëhet nga 5 anëtarë: 3 anëtarë nga fshati, 2 anëtarë i zgjedhë Kuvendi Komunal. Ky ishte një sqarim i vogël se si duhet që të shkojë procesi.

Dervish Qadraku – Siç e dini jam anëtarë i ri i Kuvendit dhe me duhet një sqarim se cili është dallimi në mes Këshillit të fshatit dhe kryesisë së fshatit siç i kanë edhe fshatrat e tjera, nëse ka dallime unë për vete nuk jam i njoftuar me statusin e tyre dhe kishte me qenë mirë që të na pajisni me dokumentacion në mënyrë që të dimë ne se ku është dallimi, tani për tani unë nuk mundem të them asgjë për këtë pikë besoj se në kuvend do të kemi mundësin që të diskutojmë më shumë për këtë temë.

Nënkryetari – I nderuari z. Dervish Qadraku po ju njoftoj se është Ligji për fshatin Hoçë e Madhe i cili e precizon themelimin e këtij këshilli, po ashtu ka një dallim në mes fshatit Hoçë e Madhe dhe Kryesisë së fshatrave. Këshilli i Hoçës së Madhe është obligativ dhe themelohet me ligj po ashtu këtë këshill e themelon Kuvendi i Komunës, procedurat e tjera dhe sa anëtarë janë i ceku Kryesuesi, praktika ka filluar në kohën kur është themeluar ky ligj, mandati i këtij këshilli skadon së bashku me mandatin e Kuvendit Komunal. Ky këshill e ka buxhetin e vetë të ndarë nga Qeveria Qendrore, mëditjet e anëtarëve janë të njëjta sikurse të Kuvendarëve, kurse ky këshill tjetër i fshati është i njëjtë sikurse këshillat e tjerë të fshatrave të tjerë që themelohen nga një komision i cili formohet nga Kuvendi anëtarë të ekzekutivit dhe të shoqërisë civile dhe në këtë mënyrë bëhet përzgjedhja e Kryetarëve të fshatit dhe ky këshill është i paraparë me rregullore komunale.

Kryesuesi – E qesim në aprovim Shqyrtimin e propozimit të vendimit për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 7 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e fundit për mbledhjen e sodit:

8. Të ndryshme.

Rexhep Oruçi – Edhe në mbledhjen e kaluar të Kuvendit kam propozuar që të jetë si pikë e dytë e rendit të ditës pika Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e Këshilltarëve, kërkesa ime është që në mbledhjen e ardhshme të jetë kjo si pikë e dytë arsyeja është se në fillim janë të gjithë drejtorët prezent dhe ne mundemi që ti parashtrojmë pyetje.

Dervish Qadraku – A ka gjasa që mbledhjet tona të përcillen përmes mediave vizuale, nëse jo a ka ndonjë iniciativë sepse që moti po flitet por asgjë nuk ka deri më tani, a ka gjasa që në këtë mandat të bëhet diçka.

Kryesuesi – I nderuari z. Dervish Qadraku, besojmë se shumë shpejtë do të bëhet diçka sepse në këtë drejtim janë duke punuar. Po i përgjigjem edhe z. Rexhep Oriqit i nderuar pasi ka qen mbledhja e parë e KPF-së dhe

nuk ka pasur pyetje nga ana e juaj për këtë arsye e kemi qitur si pikë të fundit kurse herrave tjera do të jetë si pikë e dytë e rendit të ditës.

Nënkryetari – I nderuar z. Dervish Qadraku ne jemi në proces dhe që nga dje ka përfunduar veb faqja e Komunës e vjetra dhe që nga dje në ora 16:00 ka filluar zyrtarisht faqja e re dhe besoj se aty do të kemi qasje të drejtpërdrejtë, është në veb faqe një video ku është mbajtur seanca e kaluar, por ne do të shikojmë mundësit me zyrën e IT që të bëhet transmetimi drejtpërsëdrejti në mënyrë që ata që janë të interesuar të mundën ta shikojnë në veb faqe të Komunës së Rahovecit, nëse jo do të shikojmë mundësi me ndonjë televizion por fatkeqësisht televizion lokal nuk kemi por besoj se do të gjejmë zgjidhje.

Flori Boshnjaku – I nderuar Kryesues pyetje ime shkon për Drejtorin e Shërbimeve Publike ose të Urbanizmit, edhe nga qeverisja e kaluar kam kërkuar që nëpër stacione ku bëhet pritja e autobusëve të vendosen kabinat sepse rrugës nga Prishtina deri në Malishevë janë të vendosura kurse tek ne nuk janë. Kishte më qenë mirë që të shikohet a ka buxhet për këtë vit, ose nëse jo të shikohet mundësia që me rishikim të buxhetit të ndahen mjete për vendosjen e këtyre kabinave.

Nënkryetari – E nderuar znj. Flori Boshnjaku për këtë vit nuk kemi mjete për këto kabina do të shikojmë mundësin me rishikim të buxhetit, kishte më qenë mirë që ne kur të bëhet aprovimi i buxhetit për vitin e ardhshëm që të parashihet një kod për këto kabina dhe të shikohen ato pika se ku mundën të vendosen këto kabina, është shumë propozim me vend sepse presin udhëtarët në shi e borë, shumë Komuna të Kosovës i kanë prandaj është mirë që edhe Komuna jonë të i ketë.

Kryesuesi – Nëse nuk ka dikush të shtoj diçka më tepër unë ju falënderoj për pjesëmarrje, shihemi në mbledhjen e Kuvendit.

Procesmbajtësi,

Skender Hamza

K R Y E S U E S I

Afrim Dina